



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Data: 05.10.2017

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës , në mbështetje në neni 28 (1.2), neni 29, paragrafi (1) , neni 54 paragrafi (1.9), neni 3 paragrafi (1.8), neni 35 paragrafi (5) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 datë 07 Tetor 2010, (Gazeta Zyrtare nr.88/25 nëntor 2010), Neni 32 i Ligjit për Procedurën e Pergjithshme Administrative Nr. 05/L -031, (Gazeta Zyrtare/ Nr. 20 /2016 / 21.06.2016). AKK ka pranuar një kërkesë nga “SIERRA-LAB”, sh.p.k., me seli ne Prishtinë, me nr. prot. 37/16-01 dt. 17.03.2016. Kërkesa kë të beje me Autorizimin e Trupave për vlerësimin e konformitetit –Laborator testues të kualitetit të naftës dhe derivateve të naftës nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datë **05.10.2017** mori këtë:

KONKLuzion

- 1. Vlerësojmë se kërkesa e dorëzuar pranë Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka pushuar te shqyrtohet pasi që, pëlqimi apo miratimi është dhënë nga Ministria përkatëse dhe është në favor të palës.**
- 2. Autoriteti vlerëson se lënda me nr. të protokollit : 37/16-01, më datë 17.03.2016, merr epilogun sikur në pikën 1 të këtij dispozitivi**
- 3. Rasti konsiderohet i mbyllur**

ARSYETIM

Me datë 17.03.2016 Kompania “SIERRA-LAB” sh.p.k me seli ne Prishtinë ka adresuar kërkesën e saj me numër protokollit 37/16-01/H pranë AKK-së. Kërkesa kë të beje me Autorizimin e Trupave për vlerësimin e konformitetit –Laborator testues të kualitetit të naftës dhe derivateve të naftës nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,. Më këtë shkresë pala i është drejtuar Ministrisë përmes shprehjes së interesit “Autorizimi i më shumë trupave testuese dhe inspektuese për vlerësimin e konformitetit të kualitetit të naftës dhe derivateve të saj” të autorizoj më shumë se një laborator testues. Pala më këtë ka pretenduar se Ministria kë bërë shkeljen ligjit për mbrojtjen e konkurrencës duke krijuar pozitë dominuese në sektorin e kontrollit të kualitetit të naftës dhe derivateve në Kosovë.

Pala ka njoftuar se Ministria e Tregtisë pas ankesave të shumta që ka pasur nga operatorët ekonomik që i kanë plotësuar kushtet dhe me datë 20.06.2016, Ministria e ka autorizuar Kompania “Sierra -Lab”, sh.p.k për të pas të drejtën për të operuar si laborator testues i naftës dhe derivateve të naftës.

Rasti si i tille pasi që, **pëlqimi apo miratimi është dhënë nga Ministria përkatëse dhe është në favor të palës pushon të shqyrtohet** pranë Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe në bazë të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ky rast merr epilogun si ne dispozitiv të këtij

KONKLUZIONI.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative .

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Arhiva

- Ankuesi “SIERRA-Lab” sh.p.k., Prishtinë

KOMISIONI I AUTORITETI KOSOVAR TE KONKURRENCËS

(_____)

Valon Prestreshi

Kryetar

(_____)

Ahmet Krasniqi

Zv. Kryetar

(_____)

Fatime Haziri

Anëtare

(_____)

Muhamed Krasniqi

Anëtar

(_____)

Shaqir Morina

Anëtar